




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 25.02.2019

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 22.02.2019, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 62, të datës 28.01.2018, paraqitur nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (b dhe c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 8 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, (Gazeta Zyrtare Nr. 27/2008), nenin 27, shkronja (c dhe ç) dhe nenin 54 të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e propozimit për lejimin e bartjes së mjeteve financiare të pa shpenzuara nga të hyrat vetjake të vitit fiskal 2017 dhe 2018, në vitin fiskal 2019

1. Për aprovimin e propozimit Nr. 62, të datës 28.01.2019 për lejimin e bartjes së mjeteve financiare të pa shpenzuara nga të hyrat vetjake të vitit fiskal 2017 dhe 2018, në vitin fiskal 2019 në shumë të përgjithshme prej 2,525,861.87€, prej fondit burimor 22.

2. Shpërndarja e mjeteve financiare nga të hyrave vetjake të pa shpenzuara për kategoritë ekonomike në kodet e programeve dhe nënprogrameve të tyre është si vijon:

Nr/ Prog	Kodi i Nënprog	Kodi Funks	Fond Burim	Kategoria Ekonomike	Kodi i Projektit	Bartja e mjeteve financiare 2018
2.1	Infra-Publike	18162	451	22	13 – Mallra dhe sherbime	50,005.22 €
2.2	Adm-Shendetesi	73011	760	22	13 – Mallra dhe sherbime	60,455.59 €
2.3	Adm-Arsim	92010	980	22	13 – Mallra dhe sherbime	50,000.00 €
2.4	Infra-Publike	18162	451	22	14 – Komunal	67,327.00 €
2.5	Zyra e Kryetarit	16002	111	22	20 – Subvencione Transfere	20,000.00€
2.6	Adm-Shendetesi	73011	760	22	20 – Subvencione Transfere	30,003.62€
2.7	Sherb-Kulturore	85002	820	22	20 – Subvencione Transfere	20,000.00€
2.8	Adm.Arsim	92010	980	22	20 – Subvencione Transfere	30,000.00€

2.9	Buxhetimi	17502	112	22	30	44684	Bashkfinancim I Projekteve	152,657.33	
2.10	Infr. Publike	18162	451	22	30	44693	Ndertimi I rrugeve me zhavor	26,799.00	
2.11	Infr. Publike	18162	451	22	30	44699	Rreg.parkut te pishat e Sllatines se Vogël	255,798.46	
2.12	Infr. Publike	18162	451	22	30	44709	Mirmbajtja.Infrast.Kanalizimeve	23,872.95	
2.13	Infr. Publike	18162	451	22	30	44715	Vendosja e kamerave neper pikat kryesore te qytetit	54,674.32	
2.14	Planifikimi haps.dhe rreg			66015	620	22	30	40114 Asfaltimi ne Vragoli	35,000.00
2.15	Planifikimi haps.dhe rreg			66015	620	22	30	44780 Asfaltimi ne Grabovc	18,534.40
2.16	Planifikimi haps.dhe rreg			66015	620	22	30	44786 Asfaltimi ne Sllatin e Vogel	13,578.75
2.17	Planifikimi haps.dhe rreg			66015	620	22	30	44788 Asfaltimi ne Miradi te Eperme	150,165.24
2.18	Planifikimi haps.dhe rreg			66015	620	22	30	44790 Asfaltimi ne Nakarade	20,000.00
2.19	Planifikimi haps.dhe rreg			66015	620	22	30	44791 Asfaltimi ne Harilaq	11,912.40
2.20	Planifikimi haps.dhe rreg			66015	620	22	30	44793 Asfaltimi ne Henc	18,070.80
2.21	Planifikimi haps.dhe rreg			66015	620	22	30	44794 Asfaltimi ne Lismir	16,753.20
2.22	Planifikimi haps.dhe rreg			66015	620	22	30	44797 Asfaltimi ne Miradi te Poshtme	7,983.50
2.23	Planifikimi haps.dhe rreg dhe Ujesjellesit ne Komunen e Fushe Kosove			66015	620	22	30	44800 Ndertimi Kanalizimit	67,921.40
2.24	Planifikimi haps.dhe rreg			66015	620	22	30	44801 Hartimi I planeve dhe projekteve ideore	105,078.00
2.25	Planifikimi haps.dhe rreg			66015	620	22	30	46251 Asfaltimi Pomozotin	27,590.40
2.26	Planifikimi haps.dhe rreg			66015	620	22	30	44782 Asfaltimi Bardh te Madhë	50,000.00
2.27	Administrata Shendetesi	73011	760	22	30	44837	Nderti.Shtepive per raste sociale	18,007.84	
2.28	Administrata Shendetesi	73011	760	22	30	44984	Ndertimi AFF-se Fushe Kosove	140,000.00	
2.29	Administrata Shendetesi	73011	760	22	30	45711	Renovimi I shtepive per raste Sociale	60,082.60	
2.30	Administrata Shendetesi	73011	760	22	30	44852	Rregullimi I garazhave dhe objekteve percjellese,tek objekti I QK	30,000.00	
2.31	Administrata Shendetesi	73011	760	22	30	44861	Rregullimi I oborrit te QPS-se	10,000.00	
2.32	Sherbimet Kulturore	85002	820	22	30	44679	Ndertimi I palestres Sportive ne Fushe Kosove	179,890.44	
2.33	Administrata Arsim	92010	980	22	30	44916	Mir.e objekteve Shkollore	21,260.00	

2.34	Administrata Arsim	92010	980	22	30	44933	Ndertimi I shkolles Filllore ne Fushe Kosove	116,578.51
2.35	Infrastruktura Publike	18162	451	22	30	40103	Mbjellja e pemeve dekorative	49,999.70
2.36	Infrastruktura Publike ne F.Kosove	18162	451	22	30	43044	Rreg.Varrezave te deshmoreve	2,438.00
2.37	Infrastruktura Publike kendi Lojreve	18162	451	22	30	43045	Ndertimi I parqeve.Trotuareve	51,425.00
2.38	Infrastruktura Publike mirmbajtja e tyre	18162	451	22	30	44697	Vendosja e ndriqimit publik dhe	70,694.90
2.39	Infrastruktura Publike Grabovc,Sllatin e Madhe,henc dhe Lismir	18162	451	22	30	44706	Rreg.Prrockave	ne 27,932.26
2.40	Infrastruktura Publike Infrastrukturore,rrugore etj	18162	451	22	30	44708	Mirembjtja e Investimeve	11,383.42
2.41	Planifikimi haps.dhe rreg Madhe	66015	620	22	30	40113	Asfaltimi ne Sllatin e	53,134.12
2.42	Planifikimi haps.dhe rreg Kosove	66015	620	22	30	44776	Asfaltimi ne Fushe	27,143.00
2.43	Administrata Shendetesi	73011	760	22	30	44833	Blerja e Pasijeve per Shendetesi	9,860.00
2.44	Sherbimet Kulturore fushave të sportit,sallave dhe par	85002	820	22	30	43055	Mirëmbajtja e investimeve-	5,228.50
2.45	Sherbimet Kulturore Fushe Kosove.	85002	820	22	30	44679	Ndertimi I palestres Sportive ne	

256,622.00

3. Totali i mjeteve financiare të pa shpenzuara, për bartje në vitin 2019 është në shumë prej 2,525,861.87€.
4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë për Financa dhe Buxhet.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorive të Komunës dhe Arkivës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU

Nr.faq/Br.str. 43
Datë/Datum. 28. 02. 2019
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE

Datë: 26.02.2019

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 22.02.2019, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 483, të datës 14.12.2018, paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Projektimit, në lidhje me Kërkesën Nr. 05-345/03-0040174/18 të datës 11.12.2018, paraqitur nga pala 'DECO TRANS LTD'SHPK – përfaqësuar nga Dimitros (Panagiotis) Dedovsis nga Athina, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për fillimin e procedurav për ndërtimin e objektit me destinim 'Repart për riciklim të gomave të përdorura të automjeteve'

1. Për fillimin e procedurav për ndërtimin e objektit me karakter të përkohshëm (konstruksion montues), në ngastrën kadastrale Nr. P-72514014-00134-10 në sipërfaqe prej $S=5358.0m^2$ në pronësi të z. Skënder Breznica në Zonën Kadastrale Miradi e Epërme nga pala 'DECO TRANS LTD SHPK' me destinim 'Repart për riciklim të gomave të përdorura të automjeteve'.
2. Zbatimi i këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Projektimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së PUP, Drejtorisë së Inspektoratit, Palës dhe Arkivës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha



REPublika e Kosovës - Republika Kosovo
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU

Nr.faq/Bi.str. 44
Datë/Datum. 28. 02. 2019
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 26.02.2019

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 22.02.2019, bazuar në nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për blerjen e laptopëve

1. Për blerjen e laptopëve për deputetët e Kuvendit të Komunës të mandatit zgjedhor 2017-2022, Kryetarin e Komunës, Nënkryetarin e Komunës, Nënkryetarin e Komunës për Komunitete, Drejtorët e Drejtorive dhe Shefat e Sektorëve të Komunës së Fushë Kosovës.
2. Sigurimi i mjeteve financiare nga buxheti i komunës, kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit dhe Zyrës së Prokurimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Zyrës së Prokurimit dhe Arkivës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha





REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU	
Nr.faq/Br.str.	45
Data/Datum.	28.02.2019
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE	



Datë: 26.02.2019

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 22.02.2019, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 31, të datës 07.02.2019, paraqitur nga Lendita Dervisholli Prebreza – Koordinatorë e Njësitet për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 17, shkronja (i), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l) dhe nenin 68, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, në Strategjinë Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës 2013-2023, mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim të ‘Projekt-Planit Lokal për Personat me Aftësi të Kufizuar 2019 - 2024’

1. Për aprovimin në parim të ‘Projekt-Planit Lokal për Personat me Aftësi të Kufizuar në Komunën e Fushë-Kosovë 2019-2024’ dhe procedimin e tij për diskutim publik.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorive të Komunës dhe Njësitet për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorive të Komunës, NJDNJ dhe Arkivës.

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha**





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJË

Nr.faq/Br.str. 46

Data/Datum. 28.02.2019

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE

Datë: 26.02.2019

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 22.02.2019, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 42, të datës 08.02.2019, paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Projektimit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për rregullimin e infrastrukturës në 'Kompleksin 300' në Fushë-Kosovë

1. Për lejimin e rregullimit të infrastrukturës në arsim, shëndetësi, parqe, këndet e lojrave për fëmijë dhe rrugët në Kompleksin 300 në Fushë-Kosovë.
2. Sigurimi i mjeteve financiare nga buxheti i komunës, kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Projektimit, Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit dhe Zyrës së Prokurimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së PUP, Drejtorisë së FB, Zyrës së Prokurimit dhe Arkivës.

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha**





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



	REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU	
Nr.faq/Br.str. <u>64</u>		
Datë/Datum. <u>29.03.2019</u>		
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE		

Datë: 22.03.2019

Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datë 22.02.2019, pas shqyrtimit të kërkesës Nr. 30, të datës 07.02.2019, paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (d), nenin 17, shkronja (b), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 11, paragrafi 1, nën paragrafi 1.12, nenin 16, nenin 20, të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174, (Gazeta Zyrtare Nr. 30/2013), Udhëzimin Administrativ Nr. 24/2015, të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, nenin 8, paragrafi 2, nënparagrafët 2.3, 2.4, 2.5, nenin 10, të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Nr. 05/2014, për Përgjegjësitë e Autoriteteve të Planifikimit Hapësinorë si dhe Parimet dhe Procedurat për Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikim Hapësinor, nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (b), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për caktimin e vlefshmërisë së Projekt-Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës

1. Për caktimin e vlefshmërisë së Projekt-Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës, për periudhën tetëvjeçare nga dita e miratimit përfundimtar në Kuvendin e Komunës dhe konfirmimit nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
2. Harta Zonale e Komunës së Fushë-Kosovës përfshinë fazën e procesit të hartimit të saj, fazën e shqyrtimit publik, duke u mbështetur dhe përfshirë në tërësinë e saj pjesën tekstuale dhe hartografike që hartohet duke i zbatuar elementet dhe kërkesat themelore, në përputhje me dispozitat që parashihen në nenin 16, të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor dhe Udhëzimin Administrativ të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Nr. 24/2015, mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e vendimit për hapjen e shqyrtimit publik për Projekt-Hartën Zonale të Komunës së Fushë-Kosovë dhe vendimit që përcakton vlefshmërinë e hartës zonale të komunës në pikën një të vendimit, sipas ligjit dhe udhëzimeve administrative, të cekura në bazën ligjore dhe dispozitivin e vendimit të rishqyrtuar, sipas shkresës Nr. 270-2/19, të datës 31.01.2019, të Ministrisë së Mjedisit dhe

Planifikimit Hapësinor, është në kompetencë të Drejtorisë së Planifikimit Urban, në bashkërendim me Kompaninë INSI, që e harton Projekt-Hartën Zonale dhe Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në të gjitha fazat e procesit të zhvillimit të saj.

4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës së Fushë-Kosovës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtorisë së PU dhe Arkivit.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha

